

NE JEMI PJESË E



KUVENDIT TË KOSOVËS

NE E BËJMË DEMOKRACINË

FIONA (11), ELMEDINA (11), YLLI (10), ANISA (10), ERMIR (10), JEHON (11), ERONA (10), LEART (10)



Çka është demokracia dhe çka do të thotë të jetosh në demokraci? Lexoni më poshtë për ta kuptuar

Ne jetojmë në Kosovë dhe kemi të drejta, sepse vendi ynë është vend demokratik. Demokracia është qeverisje nga populli. Pra, gjithmonë fjala e popullit është e para dhe më e rëndësishmja. Kurse, fjala e popullit tregohet me anë të votës.

Vota është një e drejtë e jona, e pamohueshme. E kur jemi tek të drejtat, të mos harrojmë të përmendim faktin që demokracia na ofron shumë të drejta. Disa nga to janë: të shprehemi lirshëm, të argëtohemi, të kemi identitet etj. Gjithashtu, secili nga ne ka të drejtë të ketë një emër, një familje, strehim etj. Këtë na e mundëson demokracia, përmes elementeve të saj. Respekti, toleranca, solidariteti, paqja dhe barazia, janë këto vetëm disa nga elementet e demokracisë. Ne duhet të jetojmë në bazë të këtyre elementeve dhe nuk duhet të harrojmë se ne e bëjmë demokracinë. Falë demokracisë ne jetojmë të lumtur, të lirë dhe me plot të drejta. Ne jemi demokratët e së ardhmes.

Që nga viti 507 para erës sonë ne e kemi demokracinë. Por, në atë kohë nuk ka qenë demokracia njësoj siç është sot. Lind pyetja pse? Kjo sepse në atë kohë nuk kanë pasur të gjithë të drejtë të votojnë, por vetëm burrat të cilët konsideroheshin të pasur. Ndërsa, tani të drejtë vote kanë të gjithë personat mbi moshën 18 vjeçare. Ekzistojnë dy lloje të demokracisë, ato janë:

demokracia përfaqësuese dhe direkte. Ne në Kosovë kemi demokraci përfaqësuese. Kjo ndodh për shkak se ne i votojmë përfaqësuesit tanë. Porosia jonë për moshatarët tanë është që të gjithë të respektojmë njëri-tjetrin që të kemi shoqëri më të mirë. Ne jemi ata që mund të bëjmë një të ardhme më të ndritur. Ne jemi e ardhmja e Kosovës.



Ne e duam shkollën tonë. E drejta e shkollimit është e preferuara jonë



Gazetarët e artikullit duke punuar

TË GJITHË E KEMI TË DREJTËN E VOTËS

DIAR (10), AHMET (10), ANA (10), ARLINDA (10), FLORENTINA (10), LORIK (10), LEDION (10),

BLEND (10)


Qytetarë të dashur, të gjithë jemi të barabartë prandaj të gjithë e kemi të drejtën e votës

Zgjedhjet janë elementi kryesor i demokracisë. Me anë të votës, ne i zgjedhim përfaqësuesit e popullit. Përfaqësuesit e popullit janë deputetët, detyra e të cilëve është t'i përfaqësojnë interesat e popullit. Të drejtën e votës e kemi mbi moshën 18 vjeçare, sepse atëherë jemi më të pjekur dhe kemi më shumë njohuri. Votimi është proces shumë i rëndësishëm, sepse çdo qytetar ka të drejtë të shpreh mendimin e vet lirshëm, e shprehja e mendimit të lirë është demokraci.


Prandaj, ju ftojmë të gjithëve që të merrni pjesë në zgjedhje, sepse vota juaj bën ndryshim të madh. Pra, të gjithë duhet të jemi qytetarë aktiv në vendin tonë dhe të gjithë duhet të kontribuojmë për të mirën e vendit tonë.



Gazetarët e demokracisë




Voto dhe ndrysho të ardhmen tënde



Kandidati për deputet duke e shpalosur programin e tij



Votimi është element i demokracisë



Kuvendi i zbaton parimet e demokracisë

NE SHPREHIM MENDIMET TONA

MUHAMET (10), ARDI (10), TOENA (10), LORETA (10), JON (10), ARDITA (10), ELDINI (11)



Kuvendi, institucioni demokratik


Demokracia është qeverisje e popullit. Liria dhe barazia janë elemente shumë të rëndësishme të demokracisë.

Kuvendi ndryshe njihet si „Shtëpia e Popullit“ ku mbahen shumë seanca plenare dhe punojnë deputetët, të cilët janë përfaqësuesit e popullit. Janë tri funksione kryesore të Kuvendit, dhe ato janë: funksioni legjislativ, kontrollues dhe përfaqësues. Pra, në Kuvend miratohen ose nuk miratohen ligjet. Gjithashtu, Kuvendi mbikëqyr Qeverinë, dhe përfaqëson popullin. Ligjet janë rregulla që duhet të zbatohen dhe ai që nuk i respekton ato, do të gjykohej nga gjykata.

Në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë 120 deputetë, prej të cilëve 100 deputetë janë të kombësisë shqipëtare dhe 20 prej tyre janë të komuniteteve jo shumicë (serb, romë, ashkali, egjiptian, goran dhe turq). Propozimet e projektligjeve mund t'i bëjë Qeveria, deputetët dhe populli. Çdo njeri ka të drejtën e votës gjatë procesit zgjedhor, por duhet t'i ketë 18 vjet dhe letërnjoftimin e tij për të votuar. Qytetarët e përgjegjshëm votojnë për të mirën e vendit.

Poashtu, të gjithë kandidatët për deputet duhet të jenë të sjellshëm, të besueshëm, ta duan atdheun e tyre etj.

Ne sot mësuam se në demokraci mund të shprehemi lirshëm. Mesazhi ynë është që nëse ne shprehemi lirshëm, atëherë do të kemi një vend më të mirë.



Autorët e artikullit



Shtëpia është shumë e dashur për ne. E pikërisht për këtë arsye, demokracia na e siguron të drejtën e strehimit



Ne jetojmë të lumtur dhe pa brena. Vendi ynë është i qetë dhe paqësor. Jemi me fat që e kemi demokracinë



Të votosh do të thotë të bësh ndryshimin



Libri, shoku ynë më i mirë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU: „Zenel Hajdini“
Klasa: V/5
Vendi: Prishtinë